



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 195/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-65048-07-10-2020, me objekt “*F.V pajisje mjekësore - Mamografi*”, me fond limit 33.333.334 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 21.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ankimues: “BNT Electronics” SHPK
Rruga “Çerçiz Topulli”, Nr.17, Kashar, Tiranë

Autoriteti kontraktor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.07.2020 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-65048-07-10-2020, me objekt “F.V pajisje

mjekësore - Mamografi”, me fond limit 33.333.334 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 21.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datën 21.09.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 14.10.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “BNT Electronics” SHPK	18.996.811	Skualifikuar
2. “Montal” SHPK	20.595.000	Skualifikuar
3. “Saer Medical” SHPK	20.900.000	Kualifikuar
4. “O.E.S Distrimed” SHPK	23.260.000	Kualifikuar
5. “MSE” SHPK	24.000.000	Skualifikuar
6. “Biometric Albania” SHPK	24.570.000	Kualifikuar
7. “TBS 96” SHPK	25.000.000	Skualifikuar
8. “FEDOS” SHPK	27.000.000	Kualifikuar
9. “Medfau” SHPK	27.400.000	Skualifikuar
10. “Albaphoto” SHPK	29.000.000	Skualifikuar
11. “Linear” SHPK	32.600.000	Skualifikuar
12. “Euromend” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomikë	

II.4. Në datën 14.10.2020 operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- Në Kreun II, seksioni I i dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”, konkretisht Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, 2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe në pjeset që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST).
- Dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e specifikimeve teknike rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në DST. Në ofertën e paraqitur nga ky OE ka disa mosperputhje në dokumentacion dhe në deklaratë, konkretisht: Në deklaratën e lëshuar nga Lanmaje i datës 19.08.2020 firmosur nga James Wang deklarohej: Anoda duhet të jete

prej TUNGSTENI ose me e mire per te reduktuar dozat..... Luna MINI 8100A do te perdori material me te mire, por ne mund te sigurojme X-ray Tube AM1016T I cili eshte prej materiali TUNGSTENI dhe ploteson teresisht kerkesat tuaja.” Sipas kesaj deklarate anoda do te jete modeli AM1016T e cila eshte prej nje kompoziti materialesh Fibrash karboni. Nderkohe ne katalog eshte deklaruar dhe markuar modeli IAE AM1016 I cili eshte prej materiali Mo (Molybdenum).

- *Në po te njejten deklarate eshte deklaruar qe do te sillet kompjuter me memorie 2T ku nderkohe nga ofruesi eshte deklaruar dhe eshte paraqitur katalog i markuar per kompjuter nga prodhuesi Fujitsu Gjermani. Në katalog eshte markuar fujitsu me madhesi HDD 500GB (edhe pse ne katalog ofrohen HDD 2T por eshte markuar 500GB)*
- *Ne po te njejten deklarate eshte deklaruar qe do te sillet UPS 1000VA ku nderkohe ky produkt eshte ofruar dhe deklaruar nga prodhuesi Infosec.*
- *Në oferten e OE ka mosperputhje ndermjet deklaratave te prodhuesit dhe katalogeve te paraqitur nga kompanite prodhuese. Referuar Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, 2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar Bazuar në kriterin e sipercituar OE nuk ploteson kriteret e mëposhtme:*
 - *Detektor me të paktën 60% DQE të matur nën dozën 10mR. Në katalogun e paraqitur nga ky OE ky specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknikë siç kërkohet në DST.*
 - *Me pajisje zmadhimi: jo më pak se 1,5X o Në katalogun e paraqitur nga ky OE ky specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknikë siç kërkohet në DST.*
 - *Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19” me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Në katalogun e paraqitur nga ky OE ky specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknikë siç kërkohet në DST.*
 - *Mburoja e rrezatimit në përputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Të përfshihet kolona mbeshetese. Në katalogun e paraqitur nga ky OE ky specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknikë siç kërkohet në DST.*
 - *Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 75 cm, me frena elektromagnetike. Në katalogun e paraqitur nga ky OE ky specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknikë siç kërkohet në DST.*

II.5. Në datën 21.10.2020 operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

Pasi analizuam me kujdes arsyet e skualifikimit dhe pasi analizuam me kujdes të gjithë dosjen që është aploduar në sistemin e APP rezulton se oferta jonë është në përputhje të plotë me kërkesat e AK dhe me LPP. Për pasojë asnjë nga pretendimet e KVO nuk është i saktë i bazuar në ligj apo në

prova. Ajo çfarë vërejtëm në këtë stad, oferta jonë renditur e para me çmimin më të ulët si dhe në përputhje me të gjitha kriteret e kualifikimit, dhe në të njëjtën kohe artifat e KVO -se mbi "qartësinë" e ofertës me qëllim skualifikimin e shoqërisë tonë. Realisht nuk kishte asgjë të pa qartë dhe në të njëjtën kohe vërehet dëshira dhe nxitimi i KVO-se për ta na skualifikuar duke mos marrë fare hapin e duhur për të na kërkuar sqarime ashtu siç LPP parashikon. Theksojmë, nëse institucioni juaj do të na drejtohej me këtë kërkesë për sqarim ashtu siç parashikon LPP neni 53 pika 1 ku parashikon: Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme" oferta jonë sot do të rezultonte e kualifikuar. Për më tepër, siç edhe përmendem më lart, oferta jonë është renditur e para me çmimin më të ulët si dhe është në përputhje të plotë me kërkesat e AK dhe legjislacionit të prokurimit publik. Më poshtë lë të trajtojmë "pretendimet" e KVO-se tuaj që kanë çuar në skualifikimin e ofertës tonë :

Më poshtë po rendisim pretendimet që sipas jush kanë çuar në skualifikimin e ofertës tonë si dhe shpjegimet që oferta e jone i plotëson të gjitha specifikimet, pa përjashtim.

-Për sa i përket pretendimit tuaj: Ne Kreun II, seksioni I i dokumenteve të tenderit "Udhëzime për operatorët ekonomikë" ku përcaktohet se: "Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme "konkretisht Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, 2.3.8.: Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shënohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertës dhe të markohen me ngjyre të ndezur (të verdhe), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në [ëëë.app.gov.al](http://eeë.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jete i përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST). Dokumentacioni I paraqitur për plotësimin e specifikimeve teknike rezulton jo I plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në DST. Në ofertën e paraqitur nga ky OE ka disa mospërputhje në dokumentacion dhe në deklaratë, konkretisht: Në deklaratën e lëshuar nga Lanmage i datës 19.08.2020 firmosur nga James Wang deklarohet: Anoda duhet të jetë prej TUNGSTENI ose me e mire për të reduktuar dozat Luna MINI 81004 do të përdori material më të mirë por ne mund të sigurojme X-ray Tube AM1016T I cili është prej materiali TUNGSTENI dhe plotëson tërësisht kërkesat tuaja. " Sipas kësaj deklarate anoda do të jetë modeli AM1016T e cila është prej një kompoziti materialesh Fibrash karboni.

Sqarojmë si më poshtë: Lidhur me këtë pikë ne kemi paraqitur në tender të gjithë katalogët e përkthyer, noterizuar dhe markuar sipas kërkesës tuaj. Nuk mungon asnjë nga katalogët si dhe janë Konform kërkesës së AK për këtë procedurë. Ju shprehemi se nuk janë dorëzuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DST kur ndërkohe as nuk referoni se cila është "mangësia" në këto katalogë. Sigurisht, duke qenë se janë në përputhje të plote me kërkesën tuaj, të përkthyer,

noterizuara dhe markuara nuk kishit si te referonit një "mangesi" përreth tyre. Siç jua kemi shpjeguar, në kemi ofruar modelin e llambës IAE XM1016 e cila është prej materiali Molibdeni dhe ofron cilësi më të mira imazhi në ekzaminimet radiologjike të indeve të buta se sa llamba e kërkuar nga ju me anode Tungsten. Sipas specialisteve si edhe dokumenteve që gjenden në Internet, materiali me i mire për prodhimin e anodave të Mamografive është molibden apo aliazhe të tij. Gjithsesi, nëse ju preferoni, prodhuesi mund të vendosë të njëjtin tip llambe por me germën T në fund që përcakton që përbërja e anodës është prej Tungsteni. Ne dhe firma prodhuese Lanmage nuk e kemi përmendur asgjëkund që llamba e rrezeve X alternative IAE XM1016T ka materialin e anodës kompozit materialesh Fibrash karboni, por kemi deklaruar se materiali i saj është Molibden, me i mirë se sa është kërkuar nga ana juaj, por mund ta bëjmë prej Tungsteni, siç është kërkuar. Pretendimi juaj nuk qëndron.

- Për sa i përket pretendimit tuaj: Në po të njëjtën deklaratë është deklaruar që do të sillët kompjuter me memorie 2T ku ndërkohë nga ofruesi është deklaruar dhe është paraqitur katalog i markuar për kompjuter nga prodhuesi Fujitsu Gjermani. Në katalog është markuar fujitsu me madhësi HDD 500GB (edhe pse në katalog ofrohen HDD 2T por është markuar 500GB).

Sqarojmë sa me poshtë: Në lidhje me njësinë kompjuterike, në specifikimet teknike është kërkuar që njësia kompjuterike në dhomën e ekzaminimit të jetë 2T dhe prodhuesi ka lëshuar një deklaratë që garanton përmbushjen e kërkesave teknike dhe furnizimin me HDD me madhësi 2 TB kështu që kjo pikë është e sqaruar nga prodhuesi i cili ka konfirmuar që njësia kompjuterike do të ketë 2Tb HDD.

-Ne lidhje me pajisjen Workstation post-procesimi

Specifikimet në DST ishin: Workstation Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion T600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD 7 DVD regjistruar. Specifikimet sipas Shtojcës behen: Workstation (për "post-procesing") Të instalohet në dhomën e diagnostikimit I dedikuar për rishikimin e imazheve mamografike digjitale, Të përfshihen:

- Njësia e përpunimit kompjuterik 2 monitorë LCD min 19" me rezolucion minimal SMP Software për manipulimin e imazheve për interpretim dhe diagnostikim.

Pra, sipas shtojcës fjalinë "Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve", ndryshohet nepermjet shtojcës dhe behet" -Njësia e përpunimit kompjuterik-2 monitorë LCD min 19" me rezolucion minimal 5MP" pra, duke hequr fare specifikimin për madhësinë e HDD dhe duke lënë vetëm gjysmën e fjalisë ku specifikohet që monitorët që ndryshojnë nga 1.600x1.200 në 5 MP. Sic duket qartë, se duke cituar vetëm gjysmën e fjalisë ju keni eliminuar fare përcaktimin e madhësisë së HDD prej 2 TB ndaj e keni lënë të hapur mundësinë e vendosjes së madhësisë së HDD. Pikërisht duke u bazuar në Shtojcën është ngjyrosur konfigurimi standard i HDD; kompjuterit Fujitsu por sic edhe mund ta shikoni kompjuteri Fujitsu i ofertuar e ka në katalog HDD 2TB të cilin, BNT Electronics, si distributor i Autorizuar i Fujitsu për territorin e Shqipërisë, konfirmon vendosjen e HDD 2 TB. Për më tepër ndryshimi i kapacitetit të HDD është i paperfillshëm dhe i pandikueshëm në një sistem mamografie. Pra, edhe pse ju nuk e keni kërkuar HDD me Madhësi 2 TB pasi ju e

keni hequr fare specifikimin në ndryshimin që keni bërë në shtojce (keni eliminuar giysmen e fjalisë ku permendet kapaciteti I HDD e cila është me Bold në 2 paragrafe me sipër- shiko Shtojcen) ne do te vendosim 2TB HDD. Pretendimi juaj nuk qëndron.

- Per sa i perket pretendimit tuaj: Në po të njëjten deklaratë është cituar që do të sillet UPS 1000VA ku nderkohë lcy produkt është ofruar dhe deklaruar nga prodhuesi Infosec. Ne oferten e OE ka mosperputhje ndermjet deklaratave të prodhuesit dhe katalogëve të paraqitur nga kompanitë prodhuese. Lidhur me kete pretendim ju sqarojme si me poshte: ne kriteret e vecanta për kualifikim, është kërkuar të paraqitet për pajisjet dhe aksesoret dokumentacioni si me poshte: Katalog, i perkthyer, noterizuar dhe markuar; CE ose CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre. Autorizim nga kompania prodhuese për tregtimin e artikujve të ofruar apo nga distributori i autorizuar nga prodhuesi ku ne çdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin. Të gjithë këta elemente të harmonizuar me njeri-tjetrin determinojne sakte produktin e ofertuar. Në këtë rast, nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë për përmbushjen e këtyre kriterëve rezulton që ne kemi ofertuar dhe paraqitur produktin UPS nga kompania Infosec. Pra ne kemi paraqitur: Katalogun e perkthyer, noterizuar dhe markuar nga Infosec: CE për produktin model UPS X1 1000 EX Infosec: Katalogun e perkthyer, noterizuar dhe markuar për model UPS XI 1000 EX Infosec. Nuk ka asnjë paqartësi mbi produktin e ofertuar. Produkti i ofertuar është UPS X1 1000 EX infosec. Deklarata e paraqitur nga prodhuesi Lan mage, provon qarte se ajo mund të sjellë pajisjen e kompletuar edhe me UPS Infosec, por ne kemi vendosur që per pajisjen UPS te kërkuar lidhje direkte vete me prodhuesin Infosec dhe jo nepermjet Lunamage ku edhe kjo e fundit do te na sillte UPS nga firma Infosec. Per kete arsye kemi marre autorizim per kete produkt direkt nga jemi ne prodhuesi i UPS. Ne rastin konkret, autoriteti kontraktor eshte i garantuar per pajisjen qe do te prokuroje, lidhur ne prodhuesin dhe modelin e kerkuar. Gjykojme se nuk ka patur vend per paqartësi por gjithsesi duke qene se ligjvënësi ka parashikuar mjete" per zgjidhjen e situatave te tilla, AK duhej te na drejtohej me nje perputhje me LPP, neni 53 pika ku parashikon" Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, per sqarim ne u kerkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të ketij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme Ky do të ishte hapi i duhur nga AK per të mos nxituar me skualifikimin e ofertës tone mbi pretendime të pabazuara në prova. Pra, paraqitja e deklaratës qe UPS Infosec mund ta merrnim nga prodhuesi i pajisjes së Mamografise, eshte thjesht një informacion shtese. Për sa me sipër, pretendimi juaj nuk qëndron.

-Për sa i përket pretendimit tuaj: Ne katalogë, duhet të shënohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertës dhe të markohen me ngjyre të ndezur verdhe), artikujt e ofruar Bazuar në kriterin e sipërcituar OE nuk plotëson kriteret e mëposhtme: • Detektor me te paktën 60% DQE te matur nën dozën 10mR.

Sqarojmë sa më poshtë: Ashtu siç jeni në dijeni ju dhe të gjithë specialistet e kësaj fushe, një pajisje përbehet nga qindra specifikime teknike por vetëm një kryesoret citohen në katalog. Specifikimet

teknike periferike nuk shkruhen të gjitha në katalog dhe për këtë arsye ne kemi marrë deklaratën nga prodhuesi ku konfirmon përmbushjen e këtij specifikimi teknik. Referuar deklaratës të uploaduar ne sistem, firma Lunamini, ne piken 2 deklaron qe e përmbush specifikimin 60% DOE te matur nen dozën 10mR. Pra pretendimi juaj nuk qëndron.

-Për sa i përket pretendimit tuaj: Me pajisje zmadhimi: jo më pak se 1.5Xo. Në katalogun e paraqitur nga Icy OE lcy specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknike siç kërkohet në DST. Sqarojmë sa më poshtë: Ky pretendim nuk qëndron pasi në faqen numër 5 të katalogut Luna Mini pika d) është e shprehur dhe e markuar me të verdhe (shiko katalogun Luna mini të uploaduar) si më poshtë: Image processing: Enhance Image, Balance, Organization Reduce d) Noise, Stretch Gray, 10x Zoonm in /Zoom Out (figura e mesiperme është Kopje nga dokumentet e paraqitura në tender) Pretendimi juaj nuk qëndron.

-Për sa i përket pretendimit tuaj: Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Në katalogun e paraqitur nga lcy OE lcy specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknike siç kërkohet në DST.

Sqarojmë sa më poshtë: Kërkesat teknike në shtojcën e modifikimit janë si më poshtë: Në dhomën e diagnostikimit, ju nuk keni kërkuar monitorë LCD me rezolucion 1600x1200 por keni kërkuar Workstation me 2 monitorë LCD, minimum 19" me rezolucion minimal 5 MP (shiko te Shtojca, f.2 dhe f.3). Pikërisht, ne kemi ofertuar Workstation me 2 monitorë LCD 21" me 5 MP, pra me të mirë se sa janë kërkuar nga ana juaj. Për sa i përket HDD 2TB ne e kemi shpjeguar më sipër. Edhe këtu pretendimi juaj nuk qëndron

-Për sa i përket pretendimit tuaj: Mburoja e rrezatimit në përputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Të përfshihet kolona mbështetëse. O në katalogun e paraqitur nga Icy OE lcy specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknike siç kërkohet në DST. Sqarojmë sa më poshtë: Mbrojtja nga rrezatimet është në përputhje me standardet EN6060 1-1-3, kjo është konfirmuar nga prodhuesi në pikën numër 9 të deklaratës. Si më poshtë. 9- Our mammography sistem is compliant with standard EN60601-1-(figura e mësipërme është Kopje nga Deklarata e lëshuar nga prodhuesi e cila është paraqitur në tender) Për më tepër ne kemi paraqitur edhe CE për këtë pajisje ku konfirmon përputhshmërinë me direktivat evropiane të kërkuara. Kështu që prodhuesi garanton standardin e kërkuar nga ana juaj duke siguruar mbrojtjen e nevojshme nga rrezatimi me strukture dhe xham mbrojtës ndaj rrezeve X. Pretendimi juaj nuk qëndron,

-Për sa i përket pretendimit tuaj: Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 75 cm, me frena elektromagnetike. Ne katalogun e paraqitur nga ky OE Icy specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknike siç kërkohet në DST. Sqarojmë sa më poshtë: Në kërkesat teknike sipas shtojcës se modifikimit të specifikimeve është kërkuar: Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 70-85 cm, me frena elektromagnetike ose me frenim me strukturë vete-bllokuese. Ne kemi ofruar rregullim lartësie 700 mm me mundësi lëvizje 700mm deri në 1400 mm dhe në katalogun teknik te Luna Mini mund ta gjeni të markuar në faqen numër 4 te cituar si më poshtë. Automatic C-Arm Assembly; Elevating range of C-Am assembly: 700mm(700-1400mm. Ju kujtojmë se Vendimi KPP

342/2020 e ndryshoi specifikimin "me frena elektromanjetike" duke lejuar edhe me "struktura vetebllokuese" të cilin e pasqyruat në ndryshimin nëpërmjet shtojcës. Pajisja e ofertuar nga ana jonë është me frena elektromagnetike. Edhe në këtë pikë pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe ne i përmbushim specifikimet teknike.

- Si perfundim konkludojme: Asnjë nga pretendimet tuaja nuk qëndrojnë. Janë të gjitha të pabazuara në prova dhe në ligjin e Prokurimit Publik. Gjithashtu vihet re qartazi se nuk ka patur vend për KVO që të mos jetë i qartë nga dokumentacioni I dorezuar në tender por edhe sikur të ishte ky rast, institucioni juaj ka vepruar në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.
- Sjellim përsëri në vëmendjen tuaj se legjislacioni ka parashikuar raste të tilla dhe për këtë arsye ka parashikuar dispoziten perkatese ne LPP neni 53 pika 1 ku parashikon : 1. Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.
- Verejme deshiren tuaj per te vazhduar direkt me skualifikimin pa u sqaruar me ne si operator ekonomik ofertues. Veprimi juaj per te skualifikuar nje oferte e cila eshte ne perputhje te plote me kerkesat e parashikuara nga AK ne DST dhe me cmimin me te ulet eshte ne kundërshtim dhe me vete qellimin e Ligjit te Prokurimit Publik i cili eshte të miremenaxhoje buxhetin e shtetit. Ligjvenesit ka parashikuar mjetet e nevojshme sic eshte rasti i I sqarimit me operatorin ekonomik parashikuar ne LPP, neni 53 pika 1 pikerisht me qellimin qe te garantohet nje operator ekonomik nga veprimet e paligjshme te AK pra per mos kualifikimin e nje oferte te vlefshme por ne te njejten kohe edhe per te garantuar mireperdorimin e buxhetit ne menyre qe te mos skualifikoje nje oferte te vlefshme pa arsye dhe te kaloje tek operatori tjetër me oferte me te shtrenjte.

Kërkojmë pranimin e ankesës tone në të gjitha pikat e saj dhe kualifikimin e ofertës sonë.

II.6. Në datën 27.10.2020 me shkresën nr.3296/34 prot. operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me pranimin pjesërisht te ankesës nga autoriteti kontraktor si më poshtë:

-Lidhur me pretendimet tuaja për kriterin llambë me anodë prej tungsteni KSHA pasi lexoi pretendimet e ankimuesit dhe bëri verifikimin e dokumentacionit arsyeton si më poshtë: Ne Kreun II, seksioni I i dokumenteve te tenderit "Udhëzime për operatoret ekonomike" ku përcaktohet se: "Operatoret Ekonomike janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme "konkretisht Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, 2.3.8.: Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shënohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertës dhe të markohen me ngjyre të ndezur (të verdhe), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen ne ëëë.app.gov.al se bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet

teknike të kërkuara në DST). Dokumentacioni I paraqitur për plotësimin e specifikimeve teknike rezulton jo I plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në DST. Në ofertën e paraqitur nga ky OE ka disa mospërputhje në dokumentacion dhe në deklarata, konkretisht: Në deklaratën e lëshuar nga Lanmage i datës 19.08.2020 firmosur nga James Wang deklarohet: Anoda duhet të jetë prej TUNGSTENI ose me e mire për të reduktuar dozat Luna MINI 8100A do të përdori material më të mirë por ne mund të sigurojmë X-ray Tube AM1016T I cili është prej materiali TUNGSTENI dhe plotëson tërësisht kërkesat tuaja..” Sipas kësaj deklarate anoda do të jetë modeli IAE XM1016T e cila është prej Tungsteni. Ndërkohë në katalog është deklaruar dhe markuar modeli IAE AM1016 I cili është prej materiali Mo (Molybdenum).

Sa më sipër pretendimi juaj qëndron.

-Lidhur me pretendimet tuaja për kriterin “kompjuter me madhësi HDD 2TB”, Komisioni I Shqyrtimit të Ankesave pasi lexoi pretendimet e ankimuesit dhe bëri verifikimin e dokumentacionit arsyeton si më poshtë: Në deklaratën e lëshuar nga Lanmage i datës 18.09.2020 firmosur nga James Wang është deklaruar që do të silllet kompjuter me memorie 2T ku ndërkohë prej jush është deklaruar dhe është paraqitur katalog i markuar për kompjuter nga prodhuesi Fujitsu Gjermani. Në katalog është markuar fujitsu me madhësi HDD 500 GB (edhe pse në katalog ofrohen HDD 2T por është markuar 500 GB). Produkti i markuar prej jush në katalog nuk përputhet me kërkesën në DST. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

-Lidhur me pretendimet tuaja për kriterin “UPS 1000VA”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi lexoi pretendimet e ankimuesit dhe bëri verifikimin e dokumentacionit arsyeton si më poshtë: Në deklaratën e lëshuar nga Lanmage i datës 18.09.2020 firmosur nga James Wang është deklaruar që do të silllet UPS 1000VA ku ndërkohë ky produkt është ofruar dhe deklaruar nga prodhuesi Infosec. Në ofertën tuaj janë paraqitur dy deklarata nga dy kompani të ndryshme për të njëjtin produkt. KSHA vlerëson që produkti i ofruar është UPS 1000VA nga INFOSEC.

Sa më sipër pretendimi juaj qëndron

-Lidhur me pretendimet tuaja për kriterin “Detektor me të paktën 60% DQE të matur nën dozën 10mR”, Komisioni I Shqyrtimit të Ankesave pasi lexoi pretendimet e ankimuesit arsyeton si më poshtë: Në DST kërkohet Detektor me të paktën 60% DQE të matur nën dozën 10mR. nga verifikimet e dokumentacionit të paraqitur prej jush rezulton se në katalogun e ngarkuar në sistem ky specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknikë siç kërkohet në DST. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

-Lidhur me pretendimet tuaja për kriterin “Me pajisje zmadhimi: jo më pak se 1,5X” Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi lexoi pretendimet e ankimuesit arsyeton si më poshtë: Në DST kërkohet Me pajisje zmadhimi : Jo me pak se 1,5 X. KSHA vlerëson se: Nga verifikimi I dokumentacionit rezulton se keni ngarkuar në SPE katalogun e Luna Mini, në faqen 5 të të cilit keni markuar kriterin e sipërcituar në DST .

Sa më sipër pretendimi juaj qëndron

-Lidhur me pretendimet tuaja për kriterin “Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19” me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve.” Në DST kërkohet: Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore

LCD min 19" me rezolucion 1600 X 1200 dhe hard disk 2TB për ruajtjen e imazheve. KSHA verifikoi katalogun e paraqitur prej jush në këtë procedurë dhe vlerëson se produkti I markuar prej jush nuk përputhet me specifikimet e kërkuara në DST. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

-Lidhur me pretendimet tuaja për kriterin "Mburoja e rrezatimit në përputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Të përfshihet kolona mbështetëse", KSHA pasi lexoi pretendimet e ankimuesit arsyeton si më poshtë: Në katalogun e paraqitur prej jush ky specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknikë siç kërkohet në DST. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.

-Lidhur me pretendimet tuaja për kriterin "Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 75 cm, me frena elektromagnetike", Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi lexoi pretendimet e ankimuesit arsyeton si më poshtë: NE DST kërkohet: Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 75 cm, me frena elektromagnetike ose strukturë vetëbllokuese. KSHA verifikoi keni paraqitur katalogun në faqen 4 të të cilit është markuar kriteri: "Diapazoni ngritës i montimit C-Arm 700 mm (700-1400 mm)", por nuk ka përcaktime në lidhje me frenat elektromagnetike ose strukturën vetëbllokuese. Sa më sipër pretendimi juaj qëndron pjesërisht.

II.7. Në datën 06.11.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor, duke ngritur pretendime në lidhje me arsyet e skualifikimit të cilat nuk janë pranuar nga autoriteti kontraktor në kthim përgjigjen e ankesës së tij. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon:

[...]

KVO fillimisht kishte listuar një numer shumë të lartë "pretendimesh" me të cilat do të njiheni nepermjet dokumentacionit bashkengjitur por pas ezaurimit të ankimit në AK, rezultoi se kjo e fundit ka pranuar pjesën me të madhe të pikave objekt ankimi, gjithsesi nuk ka pranuar të gjithë ankimin edhe pse ishte mbështetur në ligj dhe në prova.

Duke qenë se ankimi është pranuar pjesërisht, po vijojmë me ankimin tonë vetëm për pikat që nuk janë pranuar nga AK:

1.AK ka pretenduar fillimisht por edhe në përgjigjen e kthyer ndaj ankesës tonë se: në deklaratën e prodhuesit është deklaruar që do të sillen kompjuter me memorie 2T ku nderkohe nga ofruesi është deklaruar dhe është paraqitur katalog i markuar për kompjuter nga prodhuesi Fujitsu Gjermani. Në katalog është markuar Fujitsu me madhësi HDD 500GB (edhe pse në katalog ofrohen HDD 2T por është markuar 500GB). Produkti i markuar prej jush në katalog nuk përputhet me kërkesën e DST.

Konstatimi i KVO -se në lidhje me kapacitetin e HDD nuk është i saktë dhe nuk qëndron. Kjo për arsye se në këtë procedurë, si aksesori të pajisjes është kërkuar:

1. Paneli i Kontrollit

2. Njësia Workstation (për post-processing).

PANELI I KONTROLLIT

Në këtë rast, AK po e "ngaterron" kompjuterin për të cilin referohet deklarata e prodhuesit pasi deklarata e prodhuesit lidhur "me memorie HDD 2TB" i referohet panelit të kontrollit (aksesori i

renditur i pari me lart) nderkohe AK e trajton kete deklarate sikur i referohet kompjuterit nga Fujitsu i cili eshte "Njesise Workstation, per post-processing" (i renditur i dyti me lart).

Shtojme ketu se deklaraten nga prodhuesi e kemi marre enkas per ti ardhur ne ndihme KVO-se pasi sic edhe ju jeni ne dijeni, katalogët nuk mbajne te gjitha te dhenat e pajisjes ose sic ndodh zakonisht, mbajne vetem disa te dhena standarde.

Ne modifikimin e specifikimeve te DST, AK ka kerkuar per panelin kontrollit ne dhomen e ekzanimit (marre nga amendamentit i specifikimeve teknike) si me poshte:

*

Paneli i kontrollit

-Te instalohet ne dhomen e ekzanimit me minimumi nje monitor LCD mm 19" me rezolucion 1600x1200 (ose ekuivalent, min 2MP) dhe hard disk 2 TB per ruajtjen e imazheve. Te perfshihet regjistruer CD/DVD

-I pajisur me Ups 1000VA

-Sistem operativ Windows 7/10 ose me mire ose sisteme operative ekuivalente

**marre nga amendamentit i specifikimeve teknike*

Ne rastin konkret paneli i kontrollit eshte kerkuar te kete kapacitetin e ruajtjes se HDD 2TB dhe jo kompjuteri Workstation nga Fujitsu. Pra, duhet pare me kujdes per tu bere dallimi qe deklarata qe AK po i referohet, eshte per panelin e kontrollit i cili vjen nga prodhuesi i pajisjes dhe jo nga firma Fujitsu pasi, per kete te fundit AK nuk ka percaktuar fare se sa e do kapacitetin e HDD.

Duke qene se ne e kemi ofertuar kete pajisje Panelin e kontrollit me 2 TB ashtu sic kerkohet nga AK, kemi marre deklaraten nga prodhuesi, deklarata te ciles i referohet AK, pasi ky specifikim nuk gjendet ne katalog. Kjo deklarate eshte marre nga firma prodhuese Lanmage qysh para hapjes se tenderit dhe eshte dorezuar ne tender. Konkretisht ne piken e 5 te deklarates citohet si me poshte:

PJESE NGA DEKLARATA E LANMAGE:

Varianti anglisht: For the console computer: to be installed in the diagnostic room with monitors with 1 LCD monitors min 19 "with a resolution of 1600x1200(or equivalent min 2MP) and a 2 TB hard for storing images. CD I DVD recorder must be included. - We will offer 2TB hard disk.

*Varianti i perkthver: Per kompjuterin e konsoles, te instalohet ne dhomen diagnostike me monitore, me 1 monitor LCD me minute 19, me rezulicion 1600*1200 (ose minus 2Mpekuivalent) dhe nje disk te ngurte 2 TB per ruajtjen e imazheve. Rregjistruesi CD/DVD duhet te persihet. Ne do te ofrojme hard disk 2 TB.*

Kjo deklarate eshte marre qe para hapjes se tenderit dhe eshte uploaduar ne SPE.

Ju kujtojme se paneli i kontrollit dhe njesia Workstation jane dy njesi te ndryshme kompjuterike te cilat kane funksione te ndryshme teknike dhe veprojne si te pavaruara nga njera-tjetra dhe nuk kane te njejtat specifikime teknike.

Ne rastin konkret, vete deklarata i referohet panelit te kontrollit ndersa kompjuteri Workstation Fujitsu, te ciles i referohet AK, nuk eshte pjese e kesaj deklarate. Sic shikohet qarte, Workstation eshte Fujitsu, nje brand komplet tjeter nga prodhuesi i pajisjes se mamogarfise Lanmage dhe ne asnje menyre nuk mund te ngaterrohet nga AK. Kjo eshte absolutisht shume e qarte dhe nuk e kuptojme se si eshte e mundur te ngaterrohet nga AK.

Ndersa ne rastin e njesise Workstation (per post-processing), AK ka kerkuar:

WORKSTATION PER POST-PROCESSING

Kerkesat ne amendamentin e DST jane si me poshte: Workstation (per "post-procesing")

Te instalohet ne dhomen e diagnostikimit

I dedikuar per rishikimin e imazheve mamografike digjitale. Te perfshihen:

-Njesia e perpunimit kompjuterik

-2 monitore LCD min 19" me rezolucion minimal 5MP

-Softuerë per manipulimin e imazheve per interpretim dhe diagnostikim

Pra, sic duket qarte ne shtojcen e publikuar nga AK ne SPE per kete procedure, per modifikimin e specifikimeve teknike, fillimisht AK ka kerkuar vetem nje Workstation dhe ne shtojce eshte bere ndryshim ku eshte kerkuar:

1. Panel kontrolli ku percaktohet kapaciteti i HDD qe eshte 2 TB

2. Workstation ku nuk eshte percaktuar kapaciteti i HDD duke ja lene te lire ofertimit nga OE.

Pra, ne kemi ofruar njesi kompjuterike Fujitsu, per te cilin AK nuk ka shprehur apo kerkuar teknikisht ne asnje vend per kapacitetin e ruajtjes se tij HDD 2TB duke e lene te hapur rrugen e OE te ofertojne modelet e tyre. Duke qene se eshte lene e hapur mundesia e ofertimit te madhesise se HDD, ne kemi ofertuar 500GB. Gjithsesi, pavarësisht se AK e ka lene te lire kapacitetin e HDD te kompjuterit Workstation, ne kemi njoftuar KVO-ne ne Ankesen tone se do e sjellim me 2TB pa kosto shtese.

Por kjo eshte pajisje tjeter, nuk e kuptojme ngaterresen e "pretenduar" dhe aludimet e AK ndermjet kerkesave per panelin e kontrollit me ate te njesise Workstation (per post-processing) ku secila prej tyre ndryshojne nga njera-tjetra dhe jane te ndara fizikisht dhe e vetmja pike qe i lidh eshte rrjeti kompjuterik permes protokollit DICOM.

Per sa me larte, nuk qendron pretendimii KVO.

2. AK, ka pretenduar se OE nuk ploteson kriteret e meposhtme: • Detektor me te pakten 60% DQE te matur nen dozen 10mR. me tej ne pergjigjen e kthyer ndaj ankeses tone, ka shtuar: ne DST eshte kerkuar Detektor me te pakten 60% DQE te matur nen dozen 10mR, nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga OE rezulton se ne katalogun e ngarkuar ne sistem, ky specifikim nuk eshte markuar dhe nuk gjendet ne katalog.

Ashtu sic jeni ne dijeni edhe ju por edhe KVO prane MSH, gjithashtu edhe te gjithë specialistet e kesaj fushe, nje pajisje perbehet nga shume specifikime teknike por vetem me kryesoret deklarohen ne katalog. Specifikimet teknike periferike apo qe kane te bejne me teknologjine shpesh nuk shkruhen ne katalog. Ne si operator ekonomik dhe MSH si autoritet kontraktues nuk mund te diktojme firmen prodhuese se si te shkruaje katalogjet teknike apo manuallet. Firma te ndryshme i paraqesin ne menyra te ndryshme kerkesat e tyre teknike.

Per kete arsye, per t'i ardhur ne ndihme KVO-se ne kemi marre deklarate ekstra nga prodhuesi i pajisjes ku konfirmon permbushjen e ketij specifikimi teknik. Deklarate e uploaduar ne system nga firma Lanmage, ju mund ta gjeni ne piken e dyte te deklarates si me poshte:

PJESE NGA DEKLARATA E LANMAGE:

Versioni anglisht: Detector at least 60% DOE and measured under the 10mR dose.-Luna Mini comply with detector DOE 60% value.

Versioni i përkthyer: Detektori te pakten 60% DOE dhe i matur nen dozen 10mR. Luna mini perputhet me vleren e detektorit DOE 60%.

Deklarate kjo e aploduar ne SPE.

Pra sic verehet, pretendimi i KVO-se nuk qendron. KVO nuk mund te mjaftohet thjeshte duke pretenduar se nuk e ka gjetur kete informacion ne katalog dhe te vazhdoi me skualifikimin. KVO duhej te vleresonte edhe deklaraten nga Lanrnage e cila permбан konfirmimin e te gjitha specifikimeve teknike te cilat nuk jane deklaruar ne katalog.

Shtojme ketu se kete deklarate e kemi marre referuar vendimit tuaj: Vendimi i KPP-se Nr 440/2020. Ne kete vendim ju shpreheni: "KPP sqaron se edhe nese kataloget nuk përmbajnë te gjitha specifikimet operatori duhet te tregohet i kujdesshëm ne plotesimin e specifikimeve teknike te kerkuara duke gjetur menyren per te vertetuar plotesimin e tyre edhe nepermjet nje dokumenti shtese nga prodhuesi ku te pasqyrohet se specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor mund te perrnbushen, pasi operatori ekonomik ka detyrimin te paraqese oferten e tij ne perputhje me te gjitha kriteret dhe specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentet e tenderit".

Per sa me siper pretendimi i KVO-se nuk qendron.

3. AK na ka skualifikuar duke pretenduar per Panelin e Kontrollit: Te instalohet ne dhomen e diagnostikimit me monitore me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion l 600x1 200 dhe hard disk 2 TB per ruajtjen e imazheve. Ne katalogun e paraqitur nga ky OE, ky specifikim nuk eshte markuar dhe nuk gjendet ne katalogët teknike sic kerkohet ne DST.

AK ne argumentimin e saj nuk i referohet se cili specifikim nuk perputhet dhe per me teper citon gabimsht specifikimet e vendosura nga vete ata ne shtojcen e publikuar ne SPE, keshtu qe ne na duhet qe te shpjegojme nje per nje:

MONITOR!

Ne shtojce e publikuar ne SPE eshte ndryshuar kerkesa nga 2 monitore LCD me rezulcion 1600x1200 duke kerkuar vetem 1 monitor LCD mete njejtat parametra (shiko shtojcen).

Ne permbushjen e ketij kriteri, ne kemi ofertuar pajisjen monitor JUSHA M260 i cili ka ekranin 21.3" LED dhe rezolucionin 1600:1200. Ky informacion gjendet edhe ne katalogun e aploduar ne SPE.

KAPACITETI I HDD

Kete e shpjeguem edhe me siper por meqenese AK e permend perseri po ju japim edhe nje here shpjegime per kete problem.

HDD 2 TB eshte pjese e panelit te kontrollit per te cilin ne kemi marre deklaraten nga prodhuesi I panelit, pikerisht nga Lanmage. Duke qene se kete panel kontrolli/kompjuter eshte ofruar nga prodhuesi Lanmage dhe ne katalogun e pajisjes, prodhuesi nuk e vendos kete informacion, ne per ti ardhur ne ndihme KVO kemi marre paraprakisht deklaraten nga prodhuesi ku konfirmon panelin/kompjuterin me 2 TB. Eshte pikerisht pika 5 e deklarates ku citon si me poshte:

Varianti anglisht: For the console computer: to be installed in the diagnostic room with monitors with 1 LCD monitors min 19 "with a resolution of 1600x1200(or equivalent min 2MP) and a 2 TB hard for storing images. CD / DVD recorder must be included. - We will offer 2TB hard disk.
*Varianti i perkthyer: Per kompjuterin e konsolës,; te instalohet ne dhomen diagnostike me monitore, me 1 monitor LCD me minute 19. me rezulicion 1600*1200 (ose minus 2Mpekuivalent) dhe nje disk te ngurte 2 TB per ruajtjen e imazheve. Regjistruesi CD/DVD duhet te pershihet. Ne do te ofrojme hard disk 2 TB.*

Pra sic verehet edhe ketu nuk qendron pretendimi i AK.

4. Per sa i perket pretendimit te AK: Mburoja e rrezatimit ne perputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Te perfshihet kolona mbeshtetese. Ne katalogun e paraqitur nga ky OE, ky specifikim nuk eshte markuar dhe nuk gjendet ne kataloget teknike sic kerkohet ne DST.

Ne oferten tone, ne kemi ofertuar mbrojtjen nga rrezatimet ne perputhje me standardet EN 60601-1-3. Ky informacion nuk gjendet ne katalog pasi sic edhe kemi permendur me lart, katalogët jane standarde dhe nuk permbajne te gjitha specifikimet teknike, ato permbajne vetem ato me kryesoret. Per kete arsye, per ti ardhur ne ndihme edhe KVO por edhe ne perputhje me sugjerimin e KPP ne Vendimin e KPP-se Nr. 440/2020, ku shpreheni " KPP sqaron se edhe nese kataloget nuk permbajne te gjitha specifikimet operatori duhet te tregohet i kujdeshem ne plotesimin e specifikimeve teknike te kerkuara duke gjetur menyren per te vertetuar plotesimin e tyre edhe nepermjet nje dokumenti shtese nga prodhuesi ku te pasqyrohet se specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor mund te permbushen, pasi operatori ekonomik ka detyrimin te paraqese oferten e tij ne perputhje me te gjitha kriteret dhe specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentet e tenderit", ne kemi marre deklarate nga prodhuesi per konfirmimin e specifikimeve te kerkuara, konkretisht ne piken 9 te kesaj deklarate citohet si me poshte:

9- Our mammography system is compliant with standard EN60601-1-3

Versioni Shqip: Versioni yne i mamografise eshte ne perputhje me standartin EN 60601-1-3. (figura e mesiperme eshte Kopje nga Deklarata e leshuar nga prodhuesi e cila eshte paraqitur ne tender). Keshtu qe prodhuesi ka deklaruar dhe garanton standardin e kerkuar nga AK duke siguruar mbrojtjen e nevojshme nga rrezatimi me strukture dhe xham mbrojtës ndaj rrezeve X. Pra, edhe per kete pretendim qe ka bere AK, prodhuesi ka bere deklarate e cila eshte uploaduar ne SPE.

Per sa me larte, pretendimi i AK, nuk qendron.

5. Per sa i perket pretendimit te AK: Rregullimi i lartesisë i motorizuar rreth 75 cm, me frena elektromagnetike. Ne katalogun e paraqitur nga ky OE, ky specifikim nuk eshte markuar dhe nuk gjendet ne kataloget teknike sic kerkohet ne DST.

AK, ne pergjigjen e kthyer ndaj ankeses tone, ka pranuar pjeserisht ankesen per kete pike duke cituar: ne katalogun perkates, faqe nr 4 ku eshte markuar kriteri: Diapazoni ngrites i montimit C-Arm 700 mm (700-1400 mm) por nuk ka percaktime ne lidhje me frenat elektromagnetike ose strukturen vetebllokuese.

Ne kerkesat teknike sipas shtojces se modifikimit te specifikimeve eshte kerkuar:

Rregullimi i lartesisë së motorizuar rreth 70-85 cm me frenë elektromagnetike ose me frenim me strukture vete-blllokuese

Ne kemi ofruar rregullim lartësie 700 mm me mundësi lëvizjeje 700 mm deri në 1400 mm dhe në katalogun teknik të Lanmage gjëni të markuar në faqen numer 4 të cituar si më poshtë.

Automatic C-Arm Assembly

a) Elevating range of C-Arm assembly: 700 mm (700 ~ 1400 mm)

Pajisja që kemi ofruar realizon frenimin me frenë elektromagnetike.

Prodhues të ndryshëm, në varësi të teknologjisë të përdorur zgjedhin mënyra të ndryshme frenimi pra me frenim elektromagnetik ose me strukture vete-blllokuese. Ne shtojcën e publikuar në SPE, pas vendimit të marrë nga KPP, është lënë e hapur mundësia e ofertimit me të dyja mënyrat e frenimit. Gjithsesi në deklaram që pajisja jone është me frenim elektromagnetik ashtu siç është kërkuar fillimisht në DST. Por, nuk e shikojmë të arsyeshme se përse AK na skualifikon duke pretenduar se në katalog nuk gjëni info për mënyrën e frenimit kur tashmë mënyra e frenimit është lënë e hapur dhe vetë AK ka lejuar të dyja mënyrat e frenimit që perdoren në pajisjet e Mamografisë, pra ka pranuar edhe frenë elektromagnetike edhe vete-blllokuese. E gjithë kjo në sajë të Vendimi KPP 342/2020 e cila ndryshoi specifikimin "me frenë elektromagnetike" duke lejuar edhe me "strukture vete-blllokuese" të cilin AK vetë ka pasqyruar në ndryshimin nepermjet shtojcës.

Në këtë rast, meqenëse AK nuk e gjente këtë informacion atëherë AK mund të na drejtohej me një Kërkesë për sqarim konform LPP, Neni 53 LPP neni 53, pika 1 ku parashikon: Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa me të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertes, përfshirë ndryshimet në cmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme". Pavarësisht kësaj, ne kemi konfirmuar që pajisja jone është me frenim elektromagnetik.

Që kështu, verëhet qartazi "dëshira" e AK për të skualifikuar një ofertë të vlefshme duke nxjerrë për të kaluar të ofertuesi i radhës me një cmim edhe me të lartë. Pra edhe në këtë rast, pretendimi i AK nuk qëndron.

Si përfundim konkludojmë:

Asnjë nga pretendimet të KVO nuk qëndrojnë. Janë absolutisht të gjitha të pa bazuara në prova dhe në ligjin e prokurimit publik. Kjo duket qartë pasi një pjesë të pretendimeve skualifikuese është detyruar t'i pranojë pasi ishin pretendime absurde.

Duket hapur se nuk ka patur në asnjë rast vend që KVO të mos ishte e qartë për çfarë është ofertuar si dhe nuk merr në konsideratë dokumentacionin e ofertes të paraqitur në këtë procedurë por i anashkallon ato si dhe akoma me qartë duket dëshira e saj për të na skualifikuar qoftë edhe për rastin e frenave që vetë i ka lejuar të dyja mënyrat e mundshme.

Sjellim perseri në vëmendjen tuaj se legjislacioni ka parashikuar raste të tilla dhe për këtë arsye ka parashikuar dispozitën perkatese në LPP neni 53, pika 1 ku parashikon: Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa me të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32

dhe 33 te ketij ligji, nuk duhet te kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes, perfshire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne te kthejne nje oferte te pavlefshme ne të vlefshme".

Duket qarte deshira per te vazhduar direkt me skualifikimin pa u sqaruar me ne si operator ekonomik ofertues. Veprimi i KVO-se per te skualifikuar nje oferte e cila eshte ne perputhje te plote me kerkesat e parashikuara nga AK ne DST dhe me cmimin me te ulet eshte ne kundërshtim dhe me vete qellimin e Ligjit te Prokurimit Publik i cili eshte mire menaxhoje buxhetin e shtetit.

Ligjvenesit ka parashikuar mjetet e nevojshme sic eshte rasti i sqarimit me operatorin ekonomik parashikuar ne LPP, neni 53 pika 1 pikerisht me qellimin qe te garantohet nje operator ekonomik nga veprimet e paligjshme te AK pra per mos kualifikimin e nje oferte te vlefshme por ne te njejtën kohe edhe per te garantuar mireperdorimin e buxhetit ne menyre qe te mos skualifikojë nje oferte te vlefshme pa arsye dhe te kalojë tek operatori tjetër me oferte me te shtrenjte.

Per me teper, ne disa raste vërejtëm se KVO ka analizuar oferten tone duke ju referuar kriterëve te parashikuara ne fillim te procedurës dhe jo ndryshime qe vete AK ka bere nepermjet shtojcës.

Kjo ne kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, neni 53 "Shqyrtimi i Ofertave" pika 3 parashikon: Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit. Pra AK nuk i eshte referuar fare ndryshimeve te bera nga vet ata por kane vleresuar oferten tone duke u bazuar ne kriteret te shfuqizuara nga vete ata.

KVO ne kete rast, ka shkelur hapur mbi parimin e perzgjedhjes se OE, LPP, neni 2 ku parashikon: Perzgjedhja e fituesve te kontratave publike realizohet ne perputhje me keto parime te pergjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose kandidateve; b) transparence ne procedurat e prokurimit; c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve.

Si perfundim, asnje nga pretendimet e AK nuk qendrojnë dhe duke qene se oferta jone ploteson kushtin e parashikuar ne LPP, neni 55" kriteret e percaktimit te ofertes fituese" pika 1/a ku parashikon: Oferta fituese duhet te jete oferta qe ne baze te kerkesave dhe kriterëve te percaktuara ne dokumentet e tenderit, ploteson kerkesat e objektit te prokurimit me cmimin me te ulet " kerkojme pranimin e ankeses tone ne te gjitha pikat e saj dhe kualifikimin e ofertes tone.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.3296/37 prot. datë 13.11.2020 protokolluar me tonën me nr.1439/2 prot. datë 17.11.2020 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, me shkresën nr.1439/5 prot. datë 24.12.2020 me lëndë “Kërkesë për asistencë”, si dhe shkresën nr. 1439/6 prot., datë 08.01.2021 me lëndë “Kërkesë e përsëritur për asistencë”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua institucionit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për asistencën e një

eksperti/konsulenti në fushën e pajisjeve mjekësore, që të asistonte pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me qëllim gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 882 prot., datë 10.02.2021, protokolluar me tonën në datën 12.02.2021 me objekt: “Kthim përgjigjeje”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, kthim përgjigje nga ana e institucionit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i cili informon se *“Referuar kërkesës tuaj për një ekspert/konsulent në fushën e pajisjeve mjekësore ju bëjmë me dije se AKSHI e ka të pamundur vënien në dispozicionin tuaj të një përfaqësuesi nisur nga situata e pandemisë ku një pjesë e punonjësve punojnë në distancë dhe pjesa tjetër është e orientuar në implementimin e shërbimeve online dhe në mbarëvajtjen e zbatimit të kontratave të lidhura rishtazi për implementimin e sistemeve me ndikim në masë të gjerë qytetarësh dhe biznesesh”*..

II.11. Në datën 19.02.2021 me shkresën nr.1397/8 prot., Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua Universitetit Politeknik të Tiranës, duke kërkuar informacion si më poshtë: *“[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga një operator ekonomik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konstatojmë se nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë, në përmbushje të kriterëve kualifikuese, ku përveç të tjerave, janë ngritur pretendime edhe në lidhje me specifikimet teknike për pajisje mjekësore dhe kryesisht me faktin e plotësimit/mosplotësimit të specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, si dhe verifikimin e katalogëve të paraqitur për këto pajisjet*

1. Pajisje Mjeksore CT Scanner.
2. Pajisje Mjeksore Mamografi.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 19/1 e vijues të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neneve 80,81 dhe 86 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 24 pika 2 të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si edhe Vendimit Nr.867 datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, kërkojmë nga ana juaj informacion nëse institucioni juaj ka Inxhinier/Ekspert të profilizuar ose jo për pajisje mjekësore për të kryer vlerësimin teknikisht të këtyre pajisjeve nëse katalogët e paraqitur nga operatorët ekonomik janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit nëse po mund të na vini në dispozicion një Inxhinier/Ekspert për vlerësimin e sipërcituar. Gjithashtu në rast të një përgjigje pozitive, kërkojmë nga ana juaj të na informoni mbi koston apo tarifat, të cilat do të mbulohen nga ankimesi.”

II.12. Me shkresën nr. 300/3 prot datë 02.03.2021, me lëndë “Kthim përgjigje”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.1397/9 datë 04.03.2021, Universiteti Politeknik i Tiranës bën me dije se:

“Në përgjigje të kërkesës tuaj Nr.1397/7 Prot., datë 19.02.2021 ku kërkohet informacion nëse institucioni ynë ka inxhinier/ekspert të profilizuar për pajisje mjekësore, ju bëjmë me dije se propozimi ynë është:

Z.Niko Hyka”

II.13. Në datën 23.03.2021, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik, u paraqit eksperti në Universitetin Politeknik të Tiranës, Z. Niko Hyka, i cili u njoh me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë ankimues, si dhe dokumentacioni (katalogët) të dorëzuara në sistem nga operatorët ekonomikë ankimues për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar Procesverbalit të mbajtur në këtë takim, eksperti brenda dy ditëve, duhet të shprehej në lidhje me kryerjen e këtij shërbimi dhe kostot financiare të tij.

II.14. Në datën 25.03.2021, është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresa me nr.1397/10 prot. me objekt *“Propozim kosto shërbimi”*, nga eksperti Dr. Niko Hyka, Ekspert i Pajisjeve Mjekësore, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.

II.15. Në datën 26.03.2021 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin e ndërmjetëm K.P.P. 1439/9, ku vendosi:

1. *Të urdhërojë kryerjen e verifikimit të katalogëve të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, nga eksperti për pajisjet mjekësore në Universitetin Politeknik të Tiranës, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-65048-07-10-2020, me objekt “F.V Pajisje mjekësore –Mamografi”, me fond limit 33.333.334 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
2. *Operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK të parapagujë për llogari të ekspertit Niko Hyka, të Universitetit Politeknik të Tiranës, shumën prej _____lekë si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës të protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nr.1397/10 prot datë 25.03.2021 për verifikimin e katalogëve të dorëzuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda datës 31.03.2021 ora 12:00.*
3. *Në datën 31.03.2021 ora 12:00 të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK shoqëruar me autorizim të posaçëm.*
4. *Të njoftojë ekspertin për kryerjen e vlerësimit të dokumentacionit të mësipërm.*

II.16. Në datën 31.03.2021 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt Seanca Dëgjimore midis operatorëve ekonomikë ankimues, ekspertit dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në mungesë, megjithëse është njoftuar me vendimin e

ndërmjetëm K.P.P 1439/9 në datë 26.03.2021. Në seancën dëgjimore Komisioni drejtoi pyetjet ekspertit, me qëllim kryerjen nga ana këtij të fundit të ekspertizës teknike të posaçme, mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të pajisjeve të dorëzuara nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK. Në procesverbalin e mbajtur gjatë kësaj seance dëgjimore midis palëve, u vendos që eksperti do të përgjigjej me shkrim brenda 7 ditëve pune nga e nesërmeja e mbajtjes së kësaj seance datë 31.03.2021.

II.17. Më anë të shkresës nr. 1439/10 prot., datë 02.04.2021, ekspertit z. Niko Hyka, i është dorëzuar dokumentacioni i nevojshëm për hartimin e raportit përfundimtar të vlerësimit nga ana e tij, sipas procesverbalit të mbajtur në datë 31.03.2021, në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, midis palëve të interesuara.

II.18. Në datën 12.04.2021, është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresa me nr.481/3 prot. me objekt “Për shtyrjen e afatit të dorëzimit të vlerësimeve për përgjigjet e kërkuara në shkresat Nr.Prot 1439/10 dhe Nr.Prot 481/2, datë 02.04.2021”, ku eksperti Dr. Niko Hyka, Ekspert i Pajisjeve Mjekësore, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës njofton se:

[...] Në dokumentacionin të cilin jam duke shqyrtuar, disa dokumente janë evidentuar të skanuara/ printuara/ kompresuara me rezolucion të ulët, çka ka sjellë vështirësi dhe vonesë në kohën e vlerësimit sipas afateve të parashikuara. Për këtë arsye në mirëkuptimin tuaj dhe brenda mundësive e afateve kohore që mundëson procedura në zhvillim, kërkoj shtyrjen e afatit të dorëzimit të raporteve të vlerësimit deri në datën 15.04.2021.

II.19. Në datën 13.04.2021 Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit Nr.597, datë 13.04.2021, vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e ekspertit në lidhje me shtyrjen e afatit, për dorëzimin nga ana e këtij të fundit të raportit përfundimtar të ekspertizës së tij, për sa i përket vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-65048-07-10-2020, me objekt “F.V Pajisje mjekësore –Mamografi”, me fond limit 33.333.334 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Të shtyjë afatin për dorëzimin e raportit përfundimtar të ekspertizës nga ana e ekspertit deri në datë 15.04.2021.

II.20. Nëpërmjet shkresës së protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 597/1 prot., datë 15.04.2021, është depozituar pranë KPP dokumenti “Raport Vlerësimi” i ekspertit Z.Niko Hyka, në lidhje me vlerësimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK, referuar pyetjeve sipas procesverbalit të mbajtur midis palëve në datë 31.03.2021.

II.21. Komisioni i Prokurimit Publik, me anë të shkresës nr. 481/7 prot., datë 28.04.2021, thërriti ekspertin z. Niko Hyka në një seancë dëgjimore me qëllim sqarimin e disa pyetjeve dhe paqartësive për Komisionin e Prokurimit Publik, për sa i përket disa prej çështjeve të trajtuara në raportin përfundimtar të dorëzuar nga eksperti.

II.22. Në datë 29.04.2021 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt seanca dëgjimore midis ekspertit dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, gjatë të cilës Komisioni i drejtoi pyetjet ekspertit, në lidhje me paqartësitë e shfaqura gjatë shqyrtimit të raportit përfundimtar të vlerësimit të dorëzuar nga ky i fundit. Gjatë kësaj seancë u mbajt një procesverbal në lidhje me pyetjet drejtuar ekspertit.

II.23. Nëpërmjet shkresës së protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 481/8 prot., datë 04.05.2021, është depozituar pranë KPP dokumenti “Kthim përgjigje për pyetjet e ngritura në takimin e datës 29.04.2021” i ekspertit Z.Niko Hyka, ku ky i fundit është përgjigjur në lidhje me pyetjet e ngritura sipas procesverbalit të mbajtur midis ekspertit dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik në datë 29.04.2021, në mjediset e KPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “BNT Electronics” SHPK se arsyet e skualifikimit “[...] *Ne po te njejen deklarate eshte deklaruar qe do te sillet kompjuter me memorie 2T ku nderkohe nga ofruesi eshte deklaruar dhe eshte paraqitur katalog i markuar per kompjuter nga prodhuesi Fujitsu Gjermani. Në katalog eshte markuar fujitsu me madhesi HDD 500GB (edhe pse ne katalog ofrohen HDD 2T por eshte markuar 500GB).*

...Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19” me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. - Në katalogun e paraqitur nga ky OE ky specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknikë siç kërkohet në DST”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 9, “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.3.8 “*Kapaciteti teknik*”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

“8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe në pjeset që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST).”

III.1.2. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 10, “*Specifikimet teknike*”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

SPECIFIKIMET TEKNIKE: MAMOGRAFI

Sistemi me rreze X të mamografisë së integruar, për ekzaminimet digjitale FFDM (Full Field Digital Mammography) bazuar në teknologjinë e Flat Panel për ekzaminim dhe diagnostikim.

Mburoja e rrezatimit në përputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Të përfshihet kolona mbështetëse.

Sistemi duhet të garantojë cilësinë më të lartë të imazhit dhe riprodhueshmërinë dhe duhet të ofrojë risi teknologjike

Struktura mbrojtëse ndaj rrezatimit të jete e përfshirë

Gjenerator me rreze X me fuqi të pakten 5kE në 35kV

Të kontrollohet me mikroprocesor një fazor, me frekuencë të lartë, me fuqi të lartë

Gama e tensionit: afërsisht 20-35 KV

Gama e mAs: 1 – 600 mA/s

Të ketë mbrojtje të tubit të rrezeve X nga mbingarkesa termike me sensor aktiv temperature të kontrolluar nga njesia qendrore.

Përzgjedhja e parametrave radiologjikë të jete automatikisht bazuar në densitetin e gjirit

Kompensim automatik të tensionit

Doze minimale për pacientin

Kolimator automatik,

I pajisur me llambe Led

Tubi I rrezeve X

Shpejtësia e rrotullimit të anodes jo më pak se 3000 rpm

Anoda të jetë prej Tungstenit ose më mirë për të zvogëluar dozën me përqendrim afërsisht 0,1-0,3 mm dhe filtrim me material Al ose ekuivalent.

Kapaciteti i nxehtësisë jo më pak se 300 kHU

Rrotullimi i Gantry për afërsisht: 0 ° / + 90 °; 0 ° / -150 ° i motorizuar,

Rrotullim i motorizuar izocentrik i krahut

Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 75 cm, me frenë elektromagnetike

Sistemi I shtypjes

Manual dhe i motorizuar me kode të ndryshme kompresimi

Me pajisje zmadhimi: jo më pak se 1,5X

Kompresimi (madhësi dhe teknika të ndryshme)

Afishim digjital i forcës së kompresimit, trashësisë, këndit, etj

Kontroll me motor lart ose poshtë me pedal te kembet,
 Celesa rregulluese në të dy anët e ngjeshjes. Pajisje për rregullim të mirë
 Paneli i sheshtë
 Madhësia aktive e detektorit jo më pak se 24x30 cm
 Detektor me të paktën 60% DQE të matur nën dozën 10mR.
 Madhësia e pikselit, maksimum 90 µm
 Perfetim optimal i imazhit për të gjithë ekranin me rezolucion të plotë të gjirit
 Për imazhim optimal të përfshirë përdorimin e AEC
 Distanca nga burimi tek imazhi 65-66 cm
 Levizje vertikale min 45-125 cm
 Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning)
 Workstation
Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD / DVD regjistruar.
 I pajisur me Ups 1000VA.
 Te jete pajisur me printer per printimin e filmave.
 Rezolucioni i printerit të jetë min 300dpi
 Sistem operativ Windows 7/10 ose më mirë ose sisteme operative ekuivalente

III.1.3. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

II. Në Shtojcën 10 të DST "Specifikimet Teknike":

Ishte: Kolimator automatik,
 I pajisur me llambë Led
 Bëhet: Kolimator automatik,
 I pajisur me llambë Led ose ekuivalente

Ishte: Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (të shmangë pixel binning)
 Bëhet: Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (të shmangë pixel binning) ose ekuivalente

Ishte:
 Workstation
 Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD / DVD regjistruar.
 I pajisur me Ups 1000VA.

Të jetë pajisur me printer për printimin e filmave.

Rezolucioni i printerit të jetë min 300dpi

Sistem operativ Windows 7/10 ose më mirë ose sisteme operative ekuivalente

Bëhet:

Paneli i kontrollit

Të instalohet në dhomën e ekzaminimit me minimumi një monitor LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 (ose ekuivalent, min 2MP) dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Të përfshihet regjistruar CD/DVD

I pajisur me Ups 1000VA

Sistem operativ Windows 7/10 ose më mirë ose sisteme operative ekuivalente

Workstation (për "post-processing")

Të instalohet në dhomën e diagnostikimit

I dedikuar për rishikimin e imazheve mamografike digjitale. Të përfshihen:

- Njësia e përpunimit kompjuterik

- 2 monitorë LCD min 19" me rezolucion minimal 5MP

- Softuerë për manipulimin e imazheve për interpretim dhe diagnostikim

Ishte: Gjenerator me rreze X me fuqi të paktën 5kV në 35kV

Bëhet: Gjenerator me rreze X me fuqi të paktën 3kV në 35kV

Ishte: Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 75 cm, me frena elektromagnetike

Bëhet: Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 70-85 cm, me frena elektromagnetike ose me frenim me strukturë vetëbllokuese

Në vijim të specifikimeve teknike, në lidhje me përshkrimin e mallit objekt prokurimi, është përcaktuar plotësimi i standardit: "EN 60601-1-3"

Sqarime:

1. Për çdo standard të përcaktuar në specifikimet teknike, AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN mbi komformitetin e standardit Evropian etj., dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

2. Mbështetur në komentet e njërit prej OE në lidhje me kërkesën për rrotullimin e gantrit +/-120 gradë, AK sqaron se rrotullimi gantrit në diapazonin +/-120 gradë është i pranueshëm për përmbushjen e rrotullimit të kërkuar të gantrit në DST pasi ofron një diapazon shumë të gjerë të lëvizjes në të dy krahët duke mundësuar përdorim të mirë në klinikën praktike.

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "BNT Electronics" SHPK, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;

- Ofertë Teknike e operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK;
- Katalog “Digital Mammography System” Luna Mini, me prodhues Lanmage;
- Katalog Infosec (të përkthyer dhe të noterizuar);
- Katalog Fujitsu Desktop Espresso P 558 (të përkthyer dhe të noterizuar);
- Katalog Jusha - M53 (të përkthyer dhe të noterizuar);
- Katalog Jusha - M260G (të përkthyer dhe të noterizuar);
- Deklaratë nga prodhuesi Lanmage, të përkthyer dhe të noterizuar, në të cilën citohet se *“Siç jeni në dijeni, katalogu / broshura, përmbajtja vetëm në specifikimet teknike më të rëndësishme dhe jo të gjitha detajet periferike mbi specifikimet teknike. Për shkak të kësaj, më këtë deklaratë ne konfirmojmë që modeli i pajisjes tuaj Luna Mini plotëson të gjitha sa vijon specifikimet e kërkuara nga institucioni juaj, specifikimet të cilat nuk përmenden në broshurë: 5. Për kompjuterin e konzollës: të instalohet në dhomën diagnostike me monitorë me 1 monitor LCD me minutë 19” me rezolucion 1600x1200 (ose minus 2MP ekuivalent) dhe një disk të ngurtë 2 TB për ruajtjen e imazheve. Regjistruesi CD/DVD duhet të përfshihet . –Ne do të ofrojmë hard disk 2TB.”.*

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.”*

III.1.6. Në nenin 27, pika 6 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:*

“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.1.7. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor pretendon: Në lidhje me njësine kompjuterike, në specifikimet teknike është kërkuar që njësia kompjuterike në dhomën e ekzaminimit të jetë 2T dhe prodhuesi ka lëshuar një deklaratë që garanton përmbushjen e kërkesave teknike dhe furnizimin me HDD me madhësi 2 TB kështu që kjo pikë është mese e sqaruar nga prodhuesi i cili ka konfirmuar që njësia kompjuterike do të ketë 2Tb HDD.

-Në lidhje me pajisjen Workstation post-procesimi Specifikimet në DST ishin: Workstation Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD 7 DVD regjistruar. Specifikimet sipas Shtojcës bëhen: Workstation (për "post-processing") Të instalohet në dhomën e diagnostikimit I dedikuar për rishikimin e imazheve mamografike digjitale, Të përfshihen:

- Njësia e përpunimit kompjuterik 2 monitorë LCD min 19" me rezolucion minimal 5MP Softuerë për manipulimin e imazheve për interpretim dhe diagnostikim. Pra, sipas shtojcës fjalinë "Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitorë LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve", ndryshohet nëpërmjet shtojcës dhe behet"

-Njësia e përpunimit kompjuterik-2 monitorë LCD min 19" me rezolucion minimal 5MP" pra, duke hequr fare specifikimin për madhësinë e HDD dhe duke lënë vetëm gjysmën e fjalisë ku specifikohet që monitorët që ndryshojnë nga 1.600x1.200 në 5 MP. Siç duket qartë, se duke cituar vetëm gjysmën e fjalisë ju keni eliminuar fare përcaktimin e madhësisë së HDD prej 2 TB ndaj e keni lënë të hapur mundësinë e vendosjes së madhësisë së HDD. Pikërisht duke u bazuar në Shtojcën është ngjyrosur konfigurimi standard i HDD; kompjuterit Fujitsu por sic edhe mund ta shikoni kompjuteri Fujitsu i ofertuar e ka në katalog HDD 2TB të cilin, BNT Electronics, si distributor i Autorizuar i Fujitsu për territorin e Shqipërisë, konfirmon vendosjen e HDD 2 TB. Për më tepër ndryshimi i kapacitetit të HDD është i papërfillshëm dhe i pandikueshëm në një sistem mamografie. Pra, edhe pse ju nuk e keni kërkuar HDD me Madhësi 2 TB pasi ju e keni hequr fare specifikimin në ndryshimin që keni bërë në shtojcë (keni eliminuar gjysmën e fjalisë ku përmendet kapaciteti i HDD e cila është me Bold në 2 paragrafe me sipër- shiko Shtojcën) në do të vendosim 2TB HDD.

Për sa i përket pretendimit tuaj: Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitorë LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Në katalogun e paraqitur nga lcy OE lcy specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknike siç kërkohet në DST.

Sqarojmë sa më poshtë: Kërkesat teknike shtojcën e modifikimit janë si më poshtë: Në dhomën e diagnostikimit, ju nuk keni kërkuar monitore LCD me rezolucion 1600x1200 por keni kërkuar Workstation me 2 monitorë LCD, minimum 19" me rezolucion minimal 5 MP (shiko te Shtojca, f.2 dhe f.3). Pikërisht, në kemi ofertuar Workstation me 2 monitorë LCD 21" me 5 MP, pra me të mirë se sa janë kërkuar nga ana juaj. Për sa i përket HDD 2TB në e kemi shpjeguar më sipër. Edhe këtu pretendimi juaj nuk qëndron.

III.1.8. Autoriteti kontraktor në kthim përgjigje argumenton: "Lidhur me pretendimet tuaja për kriterin "kompjuter me madhësi HDD 2TB", Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi lexoi pretendimet e ankimesit dhe bëri verifikimin e dokumentacionit arsyeton si më poshtë: Në deklaratën e lëshuar nga Lanmage i datës 18.09.2020 firmosur nga James Wang është deklaruar

që do të sillet kompjuter me memorie 2T ku ndërkohë prej jush është deklaruar dhe është paraqitur katalog i markuar për kompjuter nga prodhuesi Fujitsu Gjermani. Në katalog është markuar fujitsu me madhësi HDD 500 GB (edhe pse në katalog ofrohen HDD 2T por është markuar 500 GB). Produkti i markuar prej jush në katalog nuk përputhet me kërkesën në DST. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.”

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin “katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull”. Konkretisht, nisur nga arsyetja e skualifikimit, në specifikimet teknike të modifikuara nga autoriteti kontraktor, ky i fundit ka përcaktuar kërkesën *“Paneli i kontrollit - Të instalohet në dhomën e ekzaminimit me minimumi një monitor LCD min 19” me rezolucion 1600x1200 (ose ekuivalent, min 2MP) dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Të përfshihet regjistrues CD/DVD”*. Ndërsa për Workstation është kërkuar *“Workstation (për “post-procesing”) - 2 monitorë LCD min 19” me rezolucion minimal 5MP”*.

KPP sqaron se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për këto pajisje.

III.1.10. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga specifika dhe kompleksiteti i objektit të prokurimit për procedurën objekt shqyrtimi, për verifikimin e specifikimeve teknike iu drejtuar një eksperti të pavaruar, me qëllim ekspertizën teknike të posaçme, mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të pajisjeve të dorëzuara nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, konstatohet se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur, katalogët përkatës për pajisjet e mësipërme, si dhe deklaratë të lëshuar nga prodhuesi Lanmage datë 18.09.2020. Konkretisht, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, pretendimeve të këtij të fundit, si dhe raportit të dorëzuar nga eksperti i posaçëm, konstatohet se për përmbushjen e specifikimit teknik *“Paneli i kontrollit - Të instalohet në dhomën e ekzaminimit me minimumi një monitor LCD min 19” me rezolucion 1600x1200 (ose ekuivalent, min 2MP) dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve”*, të modifikuar në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik ka paraqitur Katalogët e kompanisë prodhuese Lanmage dhe bashkëlidhur tij, ka dorëzuar një deklaratë nga kjo kompani prodhuese ku citohet *“Siç jeni në dijeni, katalogu / broshura, përmbajtja vetëm në specifikimet teknike më të rëndësishme dhe jo të gjitha detajet periferike mbi specifikimet teknike. Për shkak të kësaj, më këtë deklaratë ne konfirmojmë që modeli i pajisjes tuaj Luna Mini plotëson të gjitha sa vijon specifikimet e kërkuara nga institucioni juaj, specifikimet të cilat nuk përmenden në broshurë: 5. Për kompjuterin e konzollës: të instalohet në dhomën diagnostike me monitorë me 1 monitor LCD me minutë 19” me rezolucion 1600x1200 (ose minus 2MP ekuivalent) dhe një disk të ngurtë 2 TB për ruajtjen e*

imazheve. Regjistruesi CD/DVD duhet të përfshihet . –Ne do të ofrojmë hard disk 2TB.”, duke vërtetuar kështu se do të ofrojë pajisje me kapacitet 2 TB.

Gjithashtu, në raportin e ekspertit të posaçëm, citohet se në deklaratën e lëshuar nga Lanmage garantohet instalimi i HDD 2 TB, pa dhënë informacion shtesë.

Për sa i përket arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor *“Ne po te njeften deklarate eshte deklaruar qe do te sillet kompjuter me memorie 2T ku nderkohe nga ofruesi eshte deklaruar dhe eshte paraqitur katalog i markuar per kompjuter nga prodhuesi Fujitsu Gjermani. Në katalog eshte markuar fujitsu me madhesi HDD 500GB (edhe pse ne katalog ofrohen HDD 2T por eshte markuar 500GB)”*, KPP nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, si dhe pretendimeve të këtij të fundit, vëren se operatori ekonomik ankimues ka sqaruar në ankesën e tij, se pajisja Fujitsu është paraqitur për të përmbushur kërkesën në lidhje me Workstation, ku autoriteti kontraktor në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit ka kërkuar ndër të tjera *“Workstation (për “post-procesing”) - 2 monitorë LCD min 19" me rezolucion minimal 5MP*, duke mos kërkuar kështu kapacitetin HDD 2TB.

Gjithashtu, në raportin e ekspertit të posaçëm, citohet se *“HDD – 500 Gb është pjesë e kompjuterit Workstation të propozuar nga OE. Ajo mund të ndryshohet, zëvendësohet, përditësohet në varësi të kërkesave dhe nevojave që mund të ketë përdoruesi. Pajisja kompjuter e propozuar “PC Workstation Fujitsu Espresso P 558”, mundëson shtim të kapacitetit HDD në të ardhmen”*.

Sa më sipër, KPP gjykon se operatori ekonomik me e dokumentacionin e dorëzuar, vërteton se për kërkesën *“Të instalohet në dhomën e ekzaminimit me minimumi një monitor LCD min 19“ me rezolucion 1600x1200 (ose ekuivalent, min 2MP) dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve”, do të ofrojë hard disk 2TB*, si dhe për kërkesën *“Workstation - 2 monitorë LCD min 19" me rezolucion minimal 5MP”*, do të ofrojë pajisjen Fujitsu sipas kërkesave në dokumentet e tenderit, duke përmbushur kështu specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor.

Akoma më tej, eksperti në raportin përfundimtar të vlerësimit si dhe në materialin e dorëzuar pranë KPP-së në datë 03.05.2021, në lidhje me disa pyetje të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik sipas procesverbalit të mbajtur në seancën sqaruese në datë 29.04.2021, në lidhje me përmbushjen e specifikimit teknik të mësipërm nga ana e operatorit ekonomik ankimues deklaron se në katalogun *“Fujitsu”*, të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për pajisjen Workstation, vërtetohet se kjo pajisje mund të ofrohet edhe në memorien 2000 GB = 2Tb.

Sa më sipër, vlen të theksojmë se, në rastin konkret, operatori ekonomik *“BNT Electronics” SHPK*. me dokumentacionin e paraqitur garanton, se është i autorizuar të ofrojë monitor LCD min 19“ me rezolucion 1600x1200 (ose ekuivalent, min 2MP) dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve, si dhe *“Workstation - 2 monitorë LCD min 19" me rezolucion minimal 5MP”*, duke përmbushur kështu edhe qëllimin për të cilin janë vendosur këto specifikime teknike nga ana e autoritetit kontraktor, rrjedhimisht kriteri i mësipërm do të konsiderohet i përmbushur, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *“BNT Electronics” SHPK*, qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “BNT Electronics” SHPK se arsytet e skualifikimit “[...]- Në oferten e OE ka mosperputhje ndërmjet deklaratave të prodhuesit dhe katalogeve të paraqitur nga kompanitë prodhuese. Referuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, 2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar Bazuar në kriterin e sipërcituar OE nuk plotëson kriteret e mëposhtme:
-Detektor me të paktën 60% DQE të matur nën dozën 10mR. Në katalogun e paraqitur nga ky OE ky specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknikë siç kërkohet në DST.
-Mburoja e rrezatimit në përputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Të përfshihet kolona mbështetëse. Në katalogun e paraqitur nga ky OE ky specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet në katalogët teknikë siç kërkohet në DST”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 9, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.8 “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:
“8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST).”

III.2.2. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 10, “Specifikimet teknike”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

SPECIFIKIMET TEKNIKE: MAMOGRAFI

Sistemi me rreze X të mamografisë së integruar, për ekzaminimet digjitale FFDM (Full Field Digital Mammography) bazuar në teknologjinë e Flat Panel për ekzaminim dhe diagnostikim.

Mburoja e rrezatimit në përputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Të përfshihet kolona mbështetëse.

Sistemi duhet të garantojë cilësinë më të lartë të imazhit dhe riprodhueshmërinë dhe duhet të ofrojë risi teknologjike

Struktura mbrojtëse ndaj rrezatimit të jete e përfshirë

Gjenerator me rreze X me fuqi të pakten 5kE në 35kV

Të kontrollohet me mikroprocesor një fazor, me frekuencë të lartë, me fuqi të lartë

Gama e tensionit: afërsisht 20-35 KV

Gama e mAs: 1 – 600 mA/s

Të ketë mbrojtje të tubit të rrezeve X nga mbingarkesa termike me sensor aktiv temperature të kontrolluar nga njesia qendrore.

Përzgjedhja e parametrave radiologjikë të jete automatikisht bazuar në densitetin e gjirit

Kompensim automatik të tensionit

Doze minimale për pacientin

Kolimator automatik,
 I pajisur me llambe Led
 Tubi I rrezeve X
 Shpejtesia e rrotullimitte anodes jo me pak se 3000 rpm
 Anoda të jetë prej Tungstenit ose më mirë për të zvogëluar dozën me perqendrime afërsisht 0,1-0,3 mm dhe filtrim me material Al ose ekuivalent.
 Kapaciteti i nxehtësisë jo më pak se 300 kHU
 Rrotullimi Gantry për afërsisht: $0^{\circ} / + 90^{\circ}$; $0^{\circ} / -150^{\circ}$ i motorizuar,
 Rrotullim i motorizuar izocentrik i krahut
 Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 75 cm, me frena elektromagnetike
 Sistemi I shtypjes
 Manual dhe i motorizuar me kode të ndryshme kompresimi
 Me pajisje zmadhimi: jo më pak se 1,5X
 Kompresimi (madhësi dhe teknika të ndryshme)
 Afishim digjital i forces së kompresimit, trashësisë, këndit, etj
 Kontroll me motor lart ose poshtë me pedal te kembet,
 Celesa rregulluese në të dyanët e ngjeshjes. Pajisje për rregullim të mirë
 Paneli i sheshtë
 Madhësia aktive e detektorit jo më pak se 24x30 cm
Detektor me të paktën 60% DQE të matur nën dozën 10mR.
 Madhësia e pikselit, maksimum 90 μ m
 Perfetim optimal i imazhit për të gjithë ekranin me rezolucion të plotë të gjirit
 Për imazhim optimal të përfshirë përdorimin e AEC
 Distanca nga burimi tek imazhi 65-66 cm
 Levizje vertikale min 45-125 cm
 Sistemi duhet të perftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (te shmange pixel binning)
 Workstation
 Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD / DVD regjistruar.
 I pajisur me Ups 1000VA.
 Te jete pajisur me printer per printimin e filmave.
 Rezolucioni i printerit të jetë min 300dpi
 Sistem operativ Windows 7/10 ose më mirë ose sisteme operative ekuivalente

III.2.3. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

II. Në Shtojcën 10 të DST "Specifikimet Teknike":

Ishte: Kolimator automatik,

I pajisur me llambë Led
Bëhet: Kolimator automatik,
I pajisur me llambë Led ose ekuivalente

Ishte: Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (të shmangë pixel binning)
Bëhet: Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (të shmangë pixel binning) ose ekuivalente

Ishte:
Workstation
Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitorë LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD / DVD regjistruar.
I pajisur me Ups 1000VA.

Të jetë pajisur me printer për printimin e filmave.
Rezolucioni i printerit të jetë min 300dpi
Sistem operativ Windows 7/10 ose më mirë ose sisteme operative ekuivalente
Bëhet:

Paneli i kontrollit
Të instalohet në dhomën e ekzaminimit me minimumi një monitor LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 (ose ekuivalent, min 2MP) dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Të përfshihet regjistruar CD/DVD
I pajisur me Ups 1000VA
Sistem operativ Windows 7/10 ose më mirë ose sisteme operative ekuivalente

Workstation (për "post-processing")
Të instalohet në dhomën e diagnostikimit
I dedikuar për rishikimin e imazheve mamografike digjitale. Të përfshihen:

- Njësia e përpunimit kompjuterik
- 2 monitorë LCD min 19" me rezolucion minimal 5MP
- Softuerë për manipulimin e imazheve për interpretim dhe diagnostikim

Ishte: Gjenerator me rreze X me fuqi të paktën 5kV në 35kV
Bëhet: Gjenerator me rreze X me fuqi të paktën 3kV në 35kV

Ishte: Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 75 cm, me frena elektromagnetike
Bëhet: Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 70-85 cm, me frena elektromagnetike ose me frenim me strukturë vetë-bllokuese
Në vijim të specifikimeve teknike, në lidhje me përshkrimin e mallit objekt prokurimi, është përcaktuar plotësimi i standardit: "EN 60601-1-3"

Sqarime:

1. Për çdo standard të përcaktuar në specifikimet teknike, AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN mbi konformitetin e standardit Evropian etj., dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

2. Mbështetur në komentet e njërit prej OE në lidhje me kërkesën për rrotullimin e gantrit +/-120 gradë, AK sqaron se rrotullimi gantrit në diapazonin +/-120 gradë është i pranueshëm për përmbushjen e rrotullimit të kërkuar të gantrit në DST pasi ofron një diapazon shumë të gjerë të lëvizjes në të dy krahët duke mundësuar përdorim të mirë në klinikën praktike.

III.2.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;
- Ofertë Teknike e operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK;
- Katalog “Digital Mammography System” Luna Mini, me prodhues Lanmage;
- Katalog Infosec (të përkthyer dhe të noterizuar);
- Katalog Fujitsu Desktop Espresso P 558 (të përkthyer dhe të noterizuar);
- Katalog Jusha - M53 (të përkthyer dhe të noterizuar);
- Katalog Jusha - M260G (të përkthyer dhe të noterizuar);
- Deklaratë nga prodhuesi Lanmage, të përkthyer dhe të noterizuar, në të cilën citohet se “Siç jeni në dijeni, katalogu / broshura, përmbajtja vetëm në specifikimet teknike më të rëndësishme dhe jo të gjitha detajet periferike mbi specifikimet teknike. Për shkak të kësaj, më këtë deklaratë ne konfirmojmë që modeli i pajisjes tuaj Luna Mini plotëson të gjitha sa vijon specifikimet e kërkuara nga institucioni juaj, specifikimet të cilat nuk përmenden në broshurë: 2. Detektori të paktën 60 % DQE dhe i matur nën dozën 10mR – Luna Mini përputhet me vlerën e detektorit DQE 60 %. 9. Sistemi ynë i mamografisë është në përputhje me standardin EN 60601-1-3”

III.2.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.”

III.2.6. Në nenin 27, pika 6 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin “katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull”. Konkretisht, nisur nga arsyeja e skualifikimit, në specifikimet teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar kërkesën “Detektor me të paktën 60% DQE të matur nën dozën 10mR”, si dhe kërkesën “Mburoja e rrezatimit në përputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Të përfshihet kolona mbështetëse”.

KPP sqaron se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për këto pajisje.

III.2.8. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga specifika dhe kompleksiteti i objektit të prokurimit për procedurën objekt shqyrtimi, për verifikimin e specifikimeve teknike iu drejtua një eksperti të pavaruar, me qëllim ekspertizën teknike të posaçme, mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të pajisjeve të dorëzuara nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, konstatohet se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, dokumentin “Ofertë Teknike”, katalogët përkatës për pajisjet e mësipërme, si dhe deklaratë të lëshuar nga prodhuesi Lanmage datë 18.09.2020. Konkretisht, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, pretendimeve të këtij të fundit, si dhe raportit të dorëzuar nga eksperti i posaçëm, konstatohet se për përmbushjen e specifikimeve teknike “Detektor me të paktën 60% DQE të matur nën dozën 10mR”, si dhe kërkesën “Mburoja e rrezatimit në përputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Të përfshihet kolona mbështetëse”, operatori ekonomik ka paraqitur Katalogët e kompanisë prodhuese Lanmage dhe bashkëlidhur tij, ka dorëzuar një deklaratë nga kjo kompani prodhuese ku citohet “Siç jeni në dijeni, katalogu / broshura, përmbajtja vetëm në specifikimet teknike më të rëndësishme dhe jo të gjitha detajet periferike mbi specifikimet teknike. Për shkak të kësaj, më këtë deklaratë ne konfirmojmë që modeli i pajisjes tuaj Luna Mini plotëson të gjitha sa vijon specifikimet

e kërkuara nga institucioni juaj, specifikimet të cilat nuk përmenden në broshurë: 2. Detektori të paktën 60 % DQE dhe i matur nën dozën 10mR – Luna Mini përputhet me vlerën e detektorit DQE 60 %. 9. Sistemi ynë i mamografisë është në përputhje me standardin EN 60601-1-3.”, duke vërtetuar kështu se do të ofrojë pajisjen sipas specifikimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu, në raportin e ekspertit të posaçëm, citohet se “[...] OE në katalogun e dhënë markon panel dedektimi të sheshtë (Flat panel dedector, model Wiser-08) me përbërje a-si/Csl (silici amorf/shintilues jodur cezium) pa informacione shtesë në katalogun e produktit. DQE (Efiçenca kuantike e dedektimit) është një parametër specifik për të vlerësuar cilësinë e përgjithshme të imazhit të sistemeve radiografike. Me fjalë të tjera, DQE përshkruan se sa me efektshmëri një sistem dedektimi, përkthen fotonet rënëse të rrezatimit X në sinjal të dobishëm (në raport me zhurmën), një imazh radiologjik. Sistemi ideal i dedektimit (nuk ekziston) do të kishte një DQE prej 1 (DQE 100%) që do të thotë se e gjithë energjia e rrezatimit absorbohet dhe shndërrohet në informacion visual/imazh. Në praktikë, një sistem humbet efikasitetin në frekuencat e larta hapësinore (detaje), duke arritur vlera midis 40 % dhe 50 %. Për sistemet digjitale të dedektimit në mamografi, DQE varion midis 40 % dhe 60 % në varësi të trashësisë së gjirit dhe kVp. Nëse DQE llogaritet nën 40 %, atëherë rritet niveli i ekspozimit së pacientit pasi rritet kVp. Deklarata e prodhuesit po ashtu siguron se DQE është 60 % e matur për dozën 10 mR. [...]

Për sa i përket specifikimit “Mburoja e rrezatimit në përputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Të përfshihet kolona mbështetëse” në raportin e eksperti citohet “Nuk është markuar në katalogun e pajisjes. Referuar këtij katalogu, në faqen 143 (Room layout) tregohet skema e konfigurimit të sallës ku instalohet pajisja mamografike. Mburoja e rrezatimit (nr.3) është pjesë e pajisjeve të listuara por pa u listuar/markuar nga OE.” Gjithashtu, në materialin e dorëzuar nga eksperti pranë KPP-së në datë 03.05.2021, në lidhje me disa pyetje të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik sipas procesverbalit të mbajtur në seancën sqaruese në datë 29.04.2021, eksperti në lidhje me përmbushjen e specifikimit teknik të mësipërm nga ana e operatorit ekonomik ankimmues është shprehur “Në specifikimet teknike nuk është e qartë se për kë mburojë rrezatimi bëhet fjalë. Nëse bëhet fjalë për mburojën/barrierat mbrojtëse në dalje të tubit të rrezeve X, në katalog jepet informacion për këtë aksesori i cili mbështetet në standardin EN 60601-2-45. (mbrojtja e pacientit/maska mbrojtëse fq.131). Referuar katalogut, maska mbrojtëse rezulton të jetë pjesë integrale e pajisjes. Nëse bëhet fjalë për barrierën mbrojtëse/mburojën e nevojshme në konsolën e komandimit, ajo mungon edhe pse është paraqitur në një nga skemat e katalogut të pajisjes (fq 143).”

Sa më sipër, KPP gjykon se, operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK me dokumentacionin e paraqitur garanton, se është i autorizuar të ofrojë pajisje me specifikimet teknike “Detektor me të paktën 60% DQE të matur nën dozën 10mR”, si dhe “Mburoja e rrezatimit në përputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Të përfshihet kolona mbështetëse”, duke përmbushur kështu edhe qëllimin për të cilin janë vendosur këto specifikime teknike nga ana e autoritetit kontraktor, rrjedhimisht kriteri i mësipërm do të konsiderohet i përmbushur, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vlen të theksojmë se, edhe nëse katalogët nuk përmbajnë të gjitha specifikimet operatori duhet të tregohet i kujdesëm në plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara duke gjetur mënyrën për të vërtetuar plotësimin e tyre edhe nëpërmjet një dokumenti shtesë nga prodhuesi ku të pasqyrohet se specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor mund të përmbushen, pasi operatori ekonomik ka detyrimin të paraqesë ofertën e tij në përputhje me të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Në këtë kuptim, në rastin konkret operatori ekonomik ankimues ka paraqitur deklaratë nga prodhuesi i pajisjes ku garantohej përmbushja e specifikimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “BNT Electronics” SHPK, qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “BNT Electronics” SHPK, se arsyet e skualifikimit “[...]Per sa i perket pretendimit te AK: Rregullimi i lartesisë i motorizuar rreth 75 cm, me frena elektromagnetike. Ne katalogun e paraqitur nga ky OE, ky specifikim nuk është markuar dhe nuk gjendet ne kataloget teknike sic kerkohet ne DST.

AK, ne pergjigjen e kthyer ndaj ankeses tone, ka pranuar pjeserisht ankesen per kete pike duke cituar: ne katalogun perkates, faqe nr. 4 ku është markuar kriteri: Diapazoni ngrites i montimit C-Arm 700 mm (700-1400 mm) por nuk ka percaktim ne lidhje me frenat elektromagnetike ose strukturen vetebllokuese.

Ne kerkesat teknike sipas shtojces se modifikimit te specifikimeve është kerkuar:

Rregullimi i lartesisë i motorizuar rreth 70-85 cm me frena elektromagnetike ose me frenim me strukture vete-bllokuese

Ne kemi ofruar rregullim lartesisë 700 mm me mundesi levizje 700 mm deri ne 1400 mm dhe ne katalogun teknik te Lanmage gjeni te markuar ne faqen numer 4 te cituar si me poshte.

Automatic C-Arm Assembly

a) Elevating range of C-Arm assembly: 700 mm (700 ~ 1400 mm)

Pajisja që kemi ofruar realizon frenimin me frena elektromagnetike.

Prodhues të ndryshëm, në varësi të teknologjisë të përdorur zgjedhin mënyra të ndryshme frenimi pra me frenim elektromagnetik ose me strukture vetebllokuese. Ne shtojcen e publikuar ne SPE, pas vendimit te marre nga KPP, është lene e hapur mundesia e ofertimit me te dyja menytrat e frenimit. Gjithsesi ne deklarua qe pajisja jone është me frenim elektromagnetik ashtu siç është kerkuar fillimisht ne DST. Por, nuk e shikojme te arsyeshme se perse AK na skualifikon duke pretenduar se ne katalog nuk gjen info per menyren e frenimit kur tashme menyra e frenimit është lene e hapur dhe vete AK ka lejuar te dyja menytrat e frenimit qe perdoren ne pajisjet e Mamografise, pra ka pranuar edhe frena elektomagnetike edhe vetebllokuese. E gjithë kjo ne saje te Vendimi KPP 342/2020 e cila ndryshoi specifikimin "me frena elektromagnetike" duke lejuar edhe me "strukture vetebllokuese" te cilin AK vete ka pasqyruar ne ndryshimin nëpërmjet shtojces.

Ne kete rast, meqenese AK nuk e gjente kete informacion atehere AK mund te na drejtohej me nje Kerkese per sqarim konform LPP, Neni 53 LPP neni 53, pika 1 ku parashikon: Autoriteti kontraktor, kur e shikon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre, per

shqyrtimin, vleresimin dhe krahasimin sa me te drejte te ketyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara ne nenet 32 dhe 33 te ketij ligji, nuk duhet te kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes, perfshire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne te kthejne nje oferte te pavlefshme ne te vlefshme". Pavarësisht kesaj, ne kemi konfirmuar qe pajisja jone eshte me frenim elektromagnetik.", Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 9, "*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*", pika 2.3.8 "*Kapaciteti teknik*", nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

"8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit te artikullit ne Formularin e Ofertes dhe te markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe ne pjeset qe kane lidhje me specifikimet teknike te kerkuara ne DST)."

III.3.2. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

II.Në Shtojcën 10 të DST "Specifikimet Teknike":

Ishte: Kolimator automatik,

I pajisur me llambë Led

Bëhet: Kolimator automatik,

I pajisur me llambë Led ose ekuivalente

Ishte: Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (të shmangë pixel binning)

Bëhet: Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (të shmangë pixel binning) ose ekuivalente

Ishte:

Workstation

Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitorë LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD / DVD regjistruar.

I pajisur me Ups 1000VA.

Të jetë pajisur me printer për printimin e filmave.

Rezolucioni i printerit të jetë min 300dpi

Sistem operativ Windows 7/10 ose më mirë ose sisteme operative ekuivalente

Bëhet:

Paneli i kontrollit

Të instalohet në dhomën e ekzaminimit me minimumi një monitor LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 (ose ekuivalent, min 2MP) dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Të përfshihet regjistruer CD/DVD

I pajisur me Ups 1000VA

Sistem operativ Windows7/10 ose më mirë ose sisteme operative ekuivalente

Workstation (për "post-procesing")

Të instalohet në dhomën e diagnostikimit

I dedikuar për rishikimin e imazheve mamografike digjitale. Të përfshihen:

- Njësia e përpunimit kompjuterik*
- 2 monitorë LCD min 19" me rezolucion minimal 5MP*
- Softuerë për manipulimin e imazheve për interpretim dhe diagnostikim*

Ishte: Gjenerator me rreze X me fuqi të paktën 5kV në 35kV

Bëhet: Gjenerator me rreze X me fuqi të paktën 3kV në 35kV

Ishte: Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 75 cm, me frena elektromagnetike

Bëhet: Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 70-85 cm, me frena elektromagnetike ose me frenim me strukturë vetë-bllokuese

Në vijim të specifikimeve teknike, në lidhje me përshkrimin e mallit objekt prokurimi, është përcaktuar plotësimi i standardit: "EN 60601-1-3"

Sqarime:

1.Për çdo standard të përcaktuar në specifikimet teknike, AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN mbi komformitetin e standardit Evropian etj., dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

2. Mbështetur në komentet e njërit prej OE në lidhje me kërkesën për rrotullimin e gantrit +/-120 gradë, AK sqaron se rrotullimi gantrit në diapazonin +/-120 gradë është i pranueshëm për përmbushjen e rrotullimit të kërkuar të gantrit në DST pasi ofron një diapazon shumë të gjerë të lëvizjes në të dy krahët duke mundësuar përdorim të mirë në klinikën praktike.

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "BNT Electronics" SHPK, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;
- Ofertë Teknike e operatorit ekonomik "BNT Electronics" SHPK;
- Katalog "Digital Mammography System" Luna Mini, me prodhues Lanmage;

III.3.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të

nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.”*

III.3.5. Në nenin 27, pika 6 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:*

“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.3.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin *“katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull”*. Konkretisht, nisur nga arsyja e skualifikimit, në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e specifikimeve teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar kërkesën *“Rregullimi i lartësisë së motorizuar rreth 70-85 cm, me frena elektromagnetike ose me frenim me strukturë vetë-blokuese”*.

KPP sqaron se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për këto pajisje.

III.3.7. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi, KPP konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur Katalog *“Digital Mammography System”* Luna Mini, me prodhues Lanmage, në të cilin në faqen 4 të tij është markuar specifikimi *“Elevating range of C-Arm assembly: 700 mm (700 ~ 1400mm)”*.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga specifika dhe kompleksiteti i objektit të prokurimit për procedurën objekt shqyrtimi, për verifikimin e specifikimeve teknike iu drejtua një ekspertit të pavaruar, me qëllim ekspertizën teknike të posaçme, mbi përputhshmërinë e

specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të pajisjeve të dorëzuara nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK. Në rastin konkret eksperti i pavarur në raportin përfundimtar të tij në lidhje me përmbushjen e specifikimit teknik të mësipërm nga operatori ekonomik ankimues është shprehur se: *“Në katalogun e pajisjes (faqes 124) është markuar rregullimi i lartësisë së C-arm ≥ 700 mm”*. Ndërkohë në materialin e dorëzuar nga eksperti pranë KPP-së në datë 03.05.2021, në lidhje me disa pyetje të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik sipas procesverbalit të mbajtur në seancën sqaruese në datë 29.04.2021, eksperti në lidhje me përmbushjen e specifikimit teknik të mësipërm nga ana e operatorit ekonomik ankimues është shprehur *“Në katalogun e vënë në dispozicion nuk jepet informacion nëse frenimi realizohet me frena elektromagnetike apo pneumatike. Teknologjitë e përdorura në pajisjet mamografike lidhur me sistemin e frenimit, janë kryesisht me frena elektromagnetike”*.

Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, se pajisja e ofruara nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, e plotëson specifikimin teknik në lidhje me: *“Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 70-85 cm, me frena elektromagnetike ose me frenim me strukturë vetë-bllokuese”*, KPP nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, si dhe raportit dhe përgjigjeve të dorëzuara nga eksperti i cili ka kryer verifikimin e posaçëm mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor, me specifikimet teknike të pajisjes së dorëzuara nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, konstatohet se në specifikimet teknike të katalogut të dorëzuar nga operatori ekonomik “BNT Electronics”, nuk jepet informacion nëse frenimi do të realizohet me frena elektromagnetike apo me strukturë vetëkontrolluese, specifikime të cilat parashikohen shprehimisht nga autoriteti kontraktor në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, për procedurën objekt shqyrtimi.

Akoma më tej, vlen të theksojmë se, KPP vëren se specifikimi në lidhje me mënyrën e frenimit nuk deklarohet në asnjë dokument, as në deklaratën e lëshuar nga prodhuesi dhe as në dokumentin ofertë teknike të cilën ankimuesi e ka paraqitur si dokument mbështetës të ofertës së tij për përmbushjen e specifikimeve teknike, megjithatë ky nuk është një dokument që kërkohet në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe as nuk mund të ketë vlerën e katalogut apo të një dokumenti të lëshuar nga prodhuesi në kushtet kur plotësohet nga vetë operatori ekonomik. KPP sqaron se edhe nëse katalogët nuk përmbajnë të gjitha specifikimet operatori duhet të tregohet i kujdesshëm në plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara duke gjetur mënyrën për të vërtetuar plotësimin e tyre edhe nëpërmjet një dokumenti shtesë nga prodhuesi ku të pasqyrohet se specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor mund të përmbushen, pasi operatori ekonomik ka detyrimin të paraqesë ofertën e tij në përputhje me të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në këtë kuptim, Komisioni gjykon se, për sa kohë që ky specifikim nuk gjendet në asnjë dokument të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, si dhe për sa kohë edhe eksperti i posaçëm i cili ka kryer vlerësimin në lidhje me përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të dorëzuara nga ankimuesi me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor, deklaron se në katalogun e vënë në dispozicion nuk jepet

informacion në lidhje me mënyrën e frenimit, rrjedhimisht ankimuesi nuk përmbush kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor.

III.3.8. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara dhe të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër, sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “BNT Electronics” SHPK, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “BNT Electronis” SHPK në procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur”*, me Nr.REF-65048-07-10-2020, me objekt *“F.V pajisje mjekësore - Mamografi”*, me fond limit 33.333.334 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 21.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1439 Protokolli

Datë 06.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri